



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranim / Dorezuar Prilbena/Protato Received/Delivery	24. 02 2022	2	viti god year
Organ /Rjeshtja Organ /Zjedmtca Org /Unit	Hi /Prof Bz /Prof Prof No	Shtopja Prilog &pendis	Sasia Kohzuma Quantity
SKDM/SHUK	984/2022		1/7



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1232/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1232/2021 të datës 30.12.2021 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ përmes avokatit të autorizuar \_\_\_\_\_ me adresë rruga \_\_\_\_\_ në Komunën Prishtinës, kundër Vendimit me numër 160/2021 të datës 02.12.2021 të Ministres së Drejtësisë, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 24.02.2022 mori këtë

### V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa më numër A.nr.1232/2021 e datës 30.12.2021 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ përmes avokatit të autorizuar \_\_\_\_\_
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër reference: 160/2021 i datës 02.12.2021 i Ministres së Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës.
- III. OBLIGOHET Ministria e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e prarimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin \_\_\_\_\_ në pozitën Drejtor në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e pagës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

### A r s y e t i m

Zëvendës Ministri i Ministrisë së Drejtësisë me datë 28.09.2021 në emër të Ministres së Drejtësisë ka kërkuar nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë që të inspektohet *ad hoc* në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë lidhur me kushtet e lirimit me kusht dhe përcjelljen e të paraburgosurit B.M, nga QPP Prishtinë deri në Pallatin Drejtësisë, ndërsa me datë 13.10.2021, Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë ka dorëzuar pranë kabinetit të Ministres raportin e Inspektimit nr.01-1690 ku konstatohet se ankuesi Isuf Iberdemaj ka lejuar daljen dhe përcjelljen e të burgosurit B.M nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë bazuar vetëm në kërkesën verbale të prokurorit të çështjes.

Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës me datën 26.10.2021 ka iniciuar procedurë disiplinore kundër ankuesit nën dyshimin se i njëjti ka kryer shkelje të rëndë disiplinore, ndërsa ende pa përfunduar procedura disiplinore, Ministria e Ministrisë së Drejtësisë ka marr vendimin me numër 160/2021 të datës 02.12.2021 me të cilin ankuesit i ka ndërprerë marrëdhënien e punës.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 06.12.2021 ka marr vendimin nr.26 me të cilin e ka përfunduar procedurën disiplinore, me arsyetimin se të njëjtit ju ka ndërpre marrëdhënia e punës nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë dhe se është konsumuar objekti mbi të cilin është filluar procedura disiplinore.

Ankuesi kundër vendimit me numër 16/2021 të datës 02.12.2021 të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 30.12.2021 ka parashtruar ankesën, me numër të protokollit 6425/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.01.2021 ka kërkuar përgjigje lidhur me ankesën e ankuesit nga Ministria e Drejtësisë, ndërsa me datë 14.01.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen me prova të bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 31.12.2021 me numër protokollit 1232/2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes avokatit me autorizim

Autorizimin e datës 02.12.2021; Vendimin me numër 160/2021 të datës 02.12.2021 të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë; Kontratën e punës të datës 18.03.2017; Urdhëresën e datës 26.02.2021 me numër PP/L.nr.13K/2021; Urdhërin me numër PNKR.nr.24/2021; Njoftimi mbi deklaratën e statusit të zyrtarëve publik me numër 0778/2021; Vendimin me numër 026 të datës 06.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.01.2021 me numër të protokollit 63/2022; Përgjigjen në ankesë të datës 14.01.2022 me numër të protokollit 166/2022; Vendimin me numër

1090 të datës 24.09.2021; Emali i datës 28.09.2021; Raporti me numër 01.-1690 të datës 13.10.2021 lidhur me rastin e përcjelljes të burgosurit B.M; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 26.10.2021 me numër 1206; Vendimi i datës 23.11.2021 me numër 025; Autorizimi i transportit; Urdhëri për sjellje të pandehurit të datës 26.02.2021 me numër PP/I.nr.13K/2021; Shkresa shtesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës e datës 24.01.2022; Autorizimi i Transportit i datës 26.02.2021; Njoftimin e datës 30.09.2021 ; Deklaratën e datës 30.09.2021; Deklaratën e datës 01.10.2021 të zyrtarit S.S lidhur me rastin e datës 26.02.2021; Vendimin aprovues të datës 12.10.2020 lidhur me transferimin e personit të burgosur; Raporti i datës 27.02.2021 i dhënë nga zyrtarët raportues F.Y dhe B.L; Vendimin aprovues të datës 22.10.2020 për transferimin e personit të burgosur; Vendimin aprovues të datës 20.01.2021 për transferimin e personit të burgosur; Vendimin aprovues të datës 30.01.2021 për transferimin e të burgosurit; Vendimin aprovues të datës 18.02.2021 për transferimin e personit të burgosur; Vendimin refuzues të datës 20.01.2021 për transferimin e personit të burgosur; Kërkesa me numër të protokollit 74 e datës 19.01.2021 për transferim e të burgosurit B.M; Kërkesa e datës 19.01.2021 e të burgosurit B.M që t'i bëhet transferimi në burgun e Smerkovces; Deklarata e datës 04.10.2021 e oficerit A.M. lidhur me përcjelljen e të burgosurit në Prokurorinë Themelore me datën 26.02.2021; Deklarata e datës 01.10.2021 nga oficeri A.G.; Deklarata e datës 04.10.2021 e oficerit S.B. lidhur me përcjelljen e të burgosurit B.M. me datën 04.10.2021; Vendimi me numër Ref.br.V.D.D.1.0/21 i datës 25.01.2021; Emalin e datës 07.10.2021; Emalin e datës 28.07.2021; Raportin e datës 20.07.2020 mbi gjendjen shëndetësore të të pandehurit: Raportin detal të datës 28.09.2020 për të burgosurin B.M.; Testet lidhur me planin e mbajtjes se dënimit, çështjet mjekësore, qëndrimet pro-kriminale, shoqërinë pro-kriminale, aktivitetet rekreative, abuzim me alkool/ substanca, arsimin punë, banim dhe gjendje ekonomike; Formulari me numër 278/20 i vlerësimit të rrezikut dhe nevojave; Emaili i datës 09.10.2020; Rekomandimi i datës 08.10.2020; Te dhënat e siguruara lidhur me të kaluarën e të burgosurit Bashkim Mulolli: Aktvendimin me numër të protokollit 785 të datës 02.04.2021; Emalin e datës 01.04.2021; Raport incidenti i datës 20.01.2021; Raporti iniciues me numër të protokollit 175/20; Deklarata e datës 20.01.2021 e oficerit F.P.; Deklarata e datës 20.01.2021 nga oficeri F.Q.; Deklarata e të burgosurit B.M.; Raportin informues të datës 20.01.2021; Kërkesa e datës 12.01.2021; Vendimi me numër V.D.D 1.0/21; Vendimin e datës 03.11.2021; Shkrese lidhur me sjelljet e mëhershme të burgosurit; Raporti iniciues disiplinore; Emalin e datës 19.01.2021; Shkrese lidhur me përcjelljet spitalore në QKUK me datë 10.11.2020 dhe 24.11.2020; Forma për planëzimin e vizitave e datës 05.01.2021; Kartela llogarisë bankare e të pandehurit; Njoftimi i të burgosurit për akuzën dhe kohën e seancës dëgjimore; Autorizimin me numër RN.I.nr.431/2020 të datës 12.01.2021; Certifikatën e datës 15.05.2017-19.05.2017; Certifikatën e datës 13-17.10.2014; Raporti shëndetësor i datës 20.01.2021 i pacientit I.K.; Forma për raportimin e incidentit të datës 30.10.2020; Raporti me numër të protokollit 01-1690 të datës 13.10.2021 lidhur me rastin e përcjellës së të burgosurit B.M.; Raporti me numër 16267/LK-265/21 të datës 27.09.2021 për lirim me kusht, raporti përfundimtar; Vërtetimin me numër 16867/LK-265/21 të Shërbimit Sprovues të Kosovës; Raporti me numër 16867/LK-265/21 për lirim me kusht, raporti i parë informativ; Aktgjykimi me numër PAKR.nr.134/2019; Aktgjykimi PKR.nr.712/2015 me numër të protokollit 05.04.2019; Njoftimi me numër 900/2019 për detyrimin e të dënuarit që të paraqitet në mbajtjen e dënimit me burg; Aktgjykimi me numër PML.nr.178/2019 i datës 02.07.2019; Njoftimi me numër ED.nr.900/19 i datës 09.08.2019; Shkresën e datës 19.02.2021 lidhur me bashkëpunimin në mes të personit të dënuar që ka aplikuar për lirim me kusht nga shërbimi provues; Raporti

shëndetësor i datës 19.02.2021 për të dënuarin B.M.; Shkresën lidhur me shqyrtimin për lirinë me kusht për të burgosurin B.M.; Raporti përmbledhës i datës 19.02.2021 nga ekipi profesionist i institucionit korrektues për panelin për lirim me kusht; Mendimi përmbledhës lidhur me shkallën e risocializimit të dënuarit i datës 18.02.2021; Raporti korrektues i datës 18.02.2021 mbi sjelljen e të dënuarit në institucion; Deklarata e datës 18.02.2021 e të burgosurit B.M.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji, duke trajtuar shkresat e lëndës fillimisht ka vlerësuar kompetencën lëndërore të KPMSHCK-së duke marrë parasysh dispozitat ligjore në fuqi. Vendimi nr. 16/2021 i datës 02.12.2021 i Ministres së Ministrisë së Drejtësisë është nxjerr duke u bazuar në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale Nr.04/L-149, gjegjësisht:

Neni 217

Drejtorët e Institucioneve Korrektuese

1. Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen me konkurs të hapur nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dispozitat për Shërbimin Civil, për emërimin, për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. 2. Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen përshtatshëm me dispozitat për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm. 3. Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen për periudhë kohore pesë (5) vjeçare me mundësi vazhdimi. 4. Detyrën e drejtorit të institucionit korrektues mund ta ushtroj personi (kandidati) i cili i plotëson kushtet në vijim: 4.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 4.2. të ketë përgatitje universitare; 4.3. të ketë gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku tri (3) vite përvojë pune në pozita udhëheqëse; 4.4. të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike; 4.5. të ketë reputacion moral dhe profesional, dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale. 5. Ministri vet, apo me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm mund t'i suspendoj, ose shkarkoj drejtorët e institucioneve korrektuese për shkelje ligjore apo për shkak të mos efikasitetit në punë. 6. Vendimi i Ministrit për suspendim, apo shkarkim të drejtorëve të institucioneve korrektuese është përfundimtar. 7. Institucionet korrektuese mund të kenë edhe zëvendës drejtorët, të cilët emërohen sipas procedurës, kushteve dhe kohëzgjatjes të parapara për drejtorët e institucioneve korrektuese.

Kolegji konstaton se Ligji i lartëshënuar ka hyrë në fuqi më datë 29.07.2013 dhe sipas dispozitës së lartëshënuar mënyra e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit korrektues është bërë sipas dispozitave të ligjit për shërbimin civil gjithashtu përshtatshëm me pozitën e drejtorit të përgjithshëm janë zgjedhur edhe drejtorët e institucioneve korrektuese.

Po ashtu Kolegji konstaton se sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale Nr.04/L-149 gjegjësisht:

Neni 230

## Procedura disiplinore

1. Procedurën disiplinore të punësuarve (personeli civil dhe zyrtarët korrektues) brenda institucionit korrektues e udhëheq komisioni disiplinor të cilin e emëron drejtori i institucionit korrektues. Për përgjegjësinë disiplinore vendosë drejtori i institucionit korrektues, me propozimin e komisionit disiplinor. 2. Procedurën disiplinore kundër drejtorit të institucionit korrektues dhe të punësuarve në Zyrën Qëndrore të Shërbimit Korrektues e udhëheqë Komisioni disiplinor të cilin e emëron Drejtori i Përgjithshëm. Për përgjegjësinë disiplinore vendosë Drejtori i Përgjithshëm me propozimin e Komisionit disiplinor. 3. Kundër vendimit të shkallës së parë të nxjerrë në procedurën disiplinore mund t'i parashetrohet ankesa Drejtorit të Përgjithshëm, në afat prej tetë (8) ditësh nga data e pranimit të vendimit. 4. Për shqyrtimin e ankesave dhe dhënien e propozimeve lidhur me theksimet në to dhe për ligjshmërinë e vendimeve në procedurën disiplinore, Drejtori i Përgjithshëm formon Komisionin për ankesa. 5. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me ankesën është përfundimtar. Sipas këtij ligji është rregulluar edhe procedura disiplinore për nëpunësit civilë dhe zyrtarët korrektues në mënyrë të veçantë, Kolegji konstaton se Ligji Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka hyrë në fuqi me datë 29.07.2013, ndërsa Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ka hyrë në fuqi me datë: 14.06.2010, prandaj duke pasur parasysh kohën e ligjit dhe rregullimin e ndryshëm të disa çështjeve Ligji Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka pasur epërsi në pikat të cilat kanë rregulluar ndryshe pikat e marrëdhënies së punës përfshirë edhe shkarkimin e Drejtorëve të Institucioneve Korrektuese dhe çështjet disiplinore.

Nisur nga ajo që u tha më lartë Kolegji ka analizuar edhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtar Publikë gjegjësisht datën e hyrjes në fuqi, meqenëse ky ligj ka hy në fuqi me datë: 09.07.2020, Kolegji ka trajtuar statusin e ankuesit në harmoni me:

### Neni 4

#### Nëpunësit civilë me status të veçantë

1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë.
2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës:
  - 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim;
  - 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj;
  - 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave;
  - 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime;

Nisur nga kjo dispozitë ligjore e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë pasi ka hy në fuqi ky ligj, vetëm çështjet e përshkruara në nenin 4 të ligjit të lartëpërmendur për të punësuarit në Shërbimin

Korrektues, gjegjësisht për nëpunësit civilë munden të rregullohen ndryshe nga dispozitat e Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publikë, prandaj siç shihet nga dispozita e lartëshenuar çështjet disiplinore për nëpunësit civilë të shërbimit korrektues nuk mund të trajtohen duke u thirrur në Ligjin Nr.04/L-114 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe krejt kjo ndërlidhur me nenin 85 të Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publikë në të cilën përcaktohet se: *“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”*. Kolegji sa i përket statusit të ankuesit lidhur me atë se a i takon kategorisë së nëpunësve civilë ka marrë parasysh edhe shkresën njoftuese lidhur me deklarinimin e statusit të zyrtarëve publikë nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të datës 16.06.2021 (nr i prot. është i pa dukshëm në shkresat e lëndës).

Pas shterimeve të argumenteve juridike siç është sqaruar më lartë, Kolegji konstaton se Ministria e Drejtësisë nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk mundet të zbatoj procedurë të veçantë disiplinore për nëpunësit civilë në Shërbimin Korrektues, përpos procedurës së paraparë në ligjin e lartëshenuar, prandaj për këtë arsye Ministria e Drejtësisë nuk ka mundur të bazohet në nenin 217, paragrafi 5 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit.

Kolegji, konstaton se masat disiplinore për të punësuarit në shërbimin civil të Kosovës duhet t'i ndërmerr dhe t'i shqipton vetëm Komisioni Disiplinor sipas nenit 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114.

Kolegji bazuar në ligjin Ligjin për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, referuar nenit 32 paragrafi 3 në të cilin specifikisht parashihet *“Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji”*, andaj mbi bazë të dispozitave të këtij ligji ndërprerja e marrëdhënies së punës për nëpunësit civilë nuk mund të bëhet me asnjë ligj tjetër përveç këtij ligji, andaj vendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës të ankuesit nga Ministria e Drejtësisë është në kundërshtim me këtë ligj.

Gjithashtu Kolegji konstaton se Vendimi Nr.160/2021 i datës 02.12.2021 i nënshkruar nga Zëvendës Ministri i Drejtësisë në emër të Ministres së Drejtësisë është në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht nenin 52 paragrafi 1. *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material;*, sepse Ministria e Drejtësisë nuk ka mundur të marr vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit, sepse siç është theksuar më lartë me hyrjen në fuqi të ligjit për zyrtarët publikë çështjet disiplinore lidhur me të punësuarit në SHKK, nuk mund të rregullohen ndryshe nga ky ligj dhe si rrjedhojë Ministria ka vepruar pa pasur kompetencë dhe autorizime ligjore, kur kihet parasysh neni 85 i ligjit Nr.06/L-114 ashtu siç është përmendur më lartë, si dhe është vepruar në kundërshtim me të drejtën materiale gjegjësisht

ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse kompetentë për shqiptimin e masave disiplinore është Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Prandaj, Kolegji pasi ka peshuar me kujdes këto prova një nga një dhe së bashku në tërësi, ka konstatuar se Vendimi nr.160/2021 i datës 02.12.2021 është në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara ligjore dhe si i tillë duhet të shfuqizohet me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, ashtu që Kolegji nuk është lëshuar në trajtimin e fakteve lidhur me shkeljet e ankuesit, pasi që është konstatuar se Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është marrë nga organi jo kompetent.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
LËNDA ME NUMËR A NR.1232/2021**

*Ilire Mehmeti-Shaqiri*

  
Procesmbajtëse

  
Eshref SHABANI  
  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Avokatit të
- Ministres së Ministrisë së Drejtësisë;
- Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në SHKK-së;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në SHKK-së dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.